



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 57, Datë 09.03.2018**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E DRAFT KONTRATËS TIP  
PËR SHIT-BLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË  
SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE/KESH SH.A, AKSIONET E SË  
CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJSËRISHT NGA SHTETI DHE  
FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL/OSHEE SH.A PËR PERIUdhËN  
01.01.2018 – 31.12.2018**

Në mbështetje të nenit 16, 20 gërma “h” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; neneve 5 dhe 14 të VKM nr. 244 datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 26 të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.03.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e Kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/ KESH sh.a dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal, OSHEE sh.a., për periudhën kohore 01.01.2018 – 31.12.2018,

**Konstatoi se:**

- Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 244 datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar me VKM. 729 datë 08.12.2017.
- ERE me shkresën nr. 186/4 Prot., datë 02.03.2018, u ka kërkuar shoqërive KESH sh.a dhe OSHEE sh.a të bëjnë me dije ERE-n mbi dispozitat në draft – kontratën tip për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/OSHEE sh.a për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2018, për të cilat nuk gjejnë dakortësinë respektivisht të dyja kompanitë dhe ka kërkuar dhënien e argumentave ligjor përkatës.

- Shoqëria OSHEE sh.a në vijim ka përcjellë në ERE shkresën nr. 3998/1 Prot., datë 06.03.2018, me anë të së cilës kërkon fillimin e mënjëhershëm të procedurës për të konkluduar me nënshkrimin e kësaj draft-kontrate e cila do të zgjidhte mosmarrëveshjet e krijuara mes dy shoqërive KESH sh.a dhe OSHEE sh.a.
- OSHEE sh.a në shkresën e saj shprehet se pavarësisht korrespondencave të vazhdueshme më KESH sh.a mbeten akoma të pazgjidhura pikat kyçe të saj që kanë të bëjnë me nominimet dhe penaltitetet dhe konkretisht Neni 4 “*Të drejtat dhe detyrimet e Blerësit*”, Neni 5 “*Të drejtat dhe detyrimet e Shitësit*” dhe neni 9 “*Zhdëmtimet/Kompensimet.*”
- KESH sh.a me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 186/7 Prot., datë 07.03.2018, ka përcjellë në ERE draft – kontratën tip për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/OSHEE sh.a për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2018.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE :

### **Vendosi:**

1. Fillimin e procedurës për miratimin e draft kontratës tip për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/OSHEE sh.a për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2018.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a, KESH sh.a, OST sh.a, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetin e Konkurrencës, për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**